



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 29.3.2023

Nr: 215

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**EMËRIM TË ANËTARIT TË KZAZ NR. 81, BASHKIA LIBOHOVË, ANËTARIT TË KZAZ NR. 82, BASHKIA DROPULL, TË PROPOZUAR NGA PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “ç” dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 7 të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor, Partia Demokratike e Shqipërisë me shkresën nr. 1974 prot., datë 27.03.2023 ka kërkuar emërimin e dy anëtarëve, një anëtar në KZAZ nr. 81, Bashkia Libohovë dhe një anëtar në KZAZ nr. 82, Bashkia Dropull .

Pas kryerjes së verifikimit të dokumentacionit, me plotësim të tij, dhe verifikimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezultojnë që propozimet dhe kandidaturat e paraqitura plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “ d”, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Data: 29.3.2023 Nr: 215  
Ora: 14:00



“Për emërim të anëtarit të KZAZ-së nr.81, Bashkia Libohovë, anëtarit të KZAZ-së nr.82, Bashkia Dropull, të propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

## V E N D O S:

1. Emërimin e anëtarit të KZAZ-së nr. 81, zj. Renila Kuro, Bashkia Libohovë dhe anëtarin e KZAZ-së nr. 82, z. Mite Mejdi, Bashkia Dropull, të propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

